

Sot ne Ballsh ndodhi nje akt teper i rende ne perfundi



m te ndeshjes Bylis-Laçi. Presidenti i balshjoteve, Besnik Kapllanaj, ka goditur me nje send drurit delegatin e ndeshjes Besnik Cela. Fusha e Ballshit ishte e denuar dhe per kete fakt tifozet vendas kishin marre disa kamione dhe i kishin vendosur perreth stadjumit. Cela ka kerkuar qe ndeshja mos te fillonte deri kur keto tifoza te ishin larguar. Dhe ne fakt ndeshja ka filluar me rreth 25 minuta vonese. Ndoshta ky fakt ka qene ai qe ka acaruar presidentin Kapllanaj qe me pas ka kryer ate akt teper te denueshem. Gjate gjithe ndeshjes ka patur presion mbi lojtaret e Laçit dhe tifozet nga jashte gjuanin me gure drejt stolit te Lacit dhe ne fushen e lojes. Gjithashtu ne momentin kur u vendos per nje penallti ne favor te Laçit ndeshja u nderpre per rreth 5 minuta sepse guret ishin te shumte ne drejtim te portes ku do gjuhej penalltia. Presidenti Kapllanaj ishte i denuar por ka arritur te hynte ne stadjum dhe te godiste Celen. Ky fakt konfirmon ate qe Cela tha para se te linte spitalin e Fierit dhe te nisej drejt Tiranës, qe policija e Ballshit ishte komplet apatike dhe nuk i ndihmoj zyrtaret e ndeshjes. Gjithashtu ne perfundim te ndeshjes lojtaret e Laçit ka qendruar 60 minuta ne stadjum dhe me pas eshte nevojitur shoqerimi i policise por gjate udhetimit nga stadjumi ne dalje te qytetit autobuzi laçian eshte goditur dhe i jane thyer disa xhama.